



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVO
REPUBLIKA KOSOVO

KOMUNA E KLINËS
MUNICIPALITY OF KLINA
OPŠTINA KLINA



www.komuna-klina.org

Duke u mbështetur në nenin 12 paragrafi 2 nën d. nenit 17 nën h) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale 03/L-040, nenit 8 i Rregullores Komunale për Transparencë 01nr.031-5713/2014 e dt.26.12.2014, nenit 10 nën pikën 4, dhe 16 pika 7 të Statutit të Komunës, Kuvendi i Komunës së Klinës në seancën e IX-të të rregullt, të mbajtur më 31.10.2016, mori këtë:

V E N D I M

Për

Vënien në Diskutim Publik të Draft-Planit Zhvillimor të Arsimit 2017-2019
në Komunën e Klinës

I

Miratohet vendimi për venje në diskutim publik të Draft-Planit Zhvillimor të Arsimit për periudhën 2017-2019 për Komunën e Klinës.

II

Venja në Diskutim Publik e këtij Draft-planit Zhvillimor të Arsimit si në pikën 1 të këtij Vendimi bëhet me qëllimin e dhënies së kontributit nga të gjitha institucionet, ekspertët e fushës përkatëse dhe qytetarët që ky Plan të jetë sa më funksional nga subjektet implementues dhe të tjerë.

III

Brenda 15 ditëve të diskutimit publik të gjithë qytetarët e Komunës së Klinës, personat fizikë dhe juridikë dhe të gjithë të interesuarit mund të marrin Draft - planin Zhvillimor të Arsimit 2017-2019 në Drejtorinë përkatëse apo në Shërbimin për Punë të Kuvendit në objektin e Komunës.

Vërejtjet dhe sugjerimet me shkrim mund të dorëzohen në Drejtorinë e Arsimit apo Shërbimi për Punë të Kuvendit.

IV

Drejtoria Komunale e Arsimit duhet të informojë Kuvendin me propozimet e dhëna në diskutim publik duke përfshirë propozimet e refuzuara si dhe ato të marra parasysh.

Kuvendi i Komunës propozimet e argumentuara dhe të mbështetura në ligj, të përfshira në tekstin përfundimtar të këtij Plani do t'i ketë parasysh me miratimin e PZHA.

Vendimi është i plotfuqishëm që nga dita e miratimit në Kuvendin e Komunës dhe 15 ditë pas protokollimit në MAPL në bazë të nenit 81 të LVL.

V

Vendimi është transparent përmes: Tabelës së shpalljeve dhe Zyrës për Informim .

KUVENDI I KOMUNËS KLINË

01 Nr. 064526/2016

Klinë, më 09.11 /2016

